

ROBERT SHKURTI  
**DET I DEHUR**  
333 HAIKU

---

BOTIMET TOENA



ROBERT SHKURTI

# DET I DEHUR

333 Haiku

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376602

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

## Parathënie

***Det i dehur* – vëllimi i ri me haiku i poetit dhe shkrimtarit Robert Shkurti.**

Robert Shkurti, autori ynë i njohur në Shqipëri dhe Itali me librat e tij në poezi e prozë, vjen kësaj radhe me vëllimin me haiku *Det i dehur*. Nuk e ka librin e parë me këtë varg të veçantë, që pak autorë e kanë trajtuar në letërsinë shqipe. *Psherëtima dallgësh* është një vëllim i mëparshëm me këtë trajtim poetik, i botuar më 2018 dhe që është botuar dhe në Rumani me titullin *Dallgët e dashurisë*. Por t’i rikthehemi *Detit të dehur*, që mban këtë titull origjinal e çmendurak, tërheqës e provokues. Lexuesit e haikut e ndiejnë menjëherë se ky titull në kopertinë do të thotë se në faqet e librit do të notojnë në një det me haiku. Dhe nuk do të zhgënjehen kur ta marrin në dorë, kur ta shfletojnë me kërshtëri, kur ta lexojnë me ëndje e kur të zhyten në thellësitë e tij.

Haiku nuk është një sprovë e lehtë për asnjë poet. E lëvruan të parët japonezët dhe prej asaj magjie që nxorën penat e tyre, poetët e të gjithë botës që shkruajnë haiku vëzhgojnë natyrën, “kapin” një imazh të çastit, ringjallin një emocion të beftë dikur të jetuar, përqendrohen në një stinë e në dukuritë natyrore, po veçanërisht në një moment të caktuar të stinës, duke e cituar atë; për zgjedhin dhe ndonjë objekt a njeri të caktuar - të gjitha këto në vetëm tri vargje me 5-7-5 rrokje.

Strikt. Rregull. Rima nuk është e domosdoshme, por është patjetër kjo strukturë. Ne duhet të ndiejmë shijen, aromën, t’i prekim, të dëgjojmë zhurmën e gjethëve apo të nuhasim erën e pishave e të barit. Të shohim vështrimin e dikujt dhe t’ia kthejmë me dashuri, pyetje, mahnitje a trishtim.

Të gjitha këto e shumë të tjera i gjejmë në peozitë e vëllimit *Det i dehur*. Mendoj se është nga më të bukurit e botuar në poezinë shqipe me varg haiku. Autori e zotëron mirë teknikën e vargut në fjalë dhe përçon një figurshmëri të madhe, thellësi mendimi e ndjenje, lirizëm, meditim, reflektim, depërtim në hollësitë më të imta të natyrës, shpirtit dhe mendjes. Pas vargjeve, mes hapësirave të tyre ndihet reflektimi i poetit mbi idetë e poezive e më pas kërkimi i detajeve.

*Hëna me brirë  
shpon veshë arushe.  
Yjet, vathë.*

Ose :

*Prag Krishtlindjeje  
yjet ndizen hapësirës.  
Globi ngjyrosur.*

Duket sikur e gjithë bota, e gjithë jeta kalon para syve të poetit. Jeta e tij, e njerëzve të dashur, e të tjerëve. Natyra është në funksion të ndjenjës, të përjetimit apo e kundërta? *Lotët e malit/shkasin mbi faqe fushe. Dashuri natyre.* Ndoshta e gjejmë këtu përgjigjen, ndoshta diku tjetër, në ekspozimin që i bën melankolisë, hollësive më të vogla e më të padukshme të ekzistencës, e pastaj, me një shpalosje të mrekullueshme e fut lexuesin në përsiatje të veçanta për madhësitinë e natyrës, e cila është e tillë përmes shikimit të vëmendshëm të syve të njeriut:

*Pikat e shiut  
dhimbje mbi tastierë  
muzikë funebër.*

Ose:

*Në pjergull varur  
ka mbetur një verigë.  
Dhelpra nën të.*

Në libër zënë vend të veçantë edhe haikut për dashurinë. Në përgjithësi lëvruesit e haikut e kryesisht japonezët, janë të kursyer në temën e dashurisë. Po kështu edhe Robert Shkurti. Ajo perceptohet, pikaset përmes gjetheve që bien, trishtimit të vjeshtës, pjergullës së rrushit dhe një vargu herë-herë paksa më guximshëm poetik për kufijtë e përmbajtjes elegante të haikut.

*Blunë e syve  
pi me etje shkretëtire.  
Deti i dehur.*

Libri është kryesisht një ode mbi natyrën dhe mbi kohën që përsëritet, mbi dashurinë për natyrën, si një dekor i jetës sonë, në të cilën jetojmë së bashku. Por, ky dekor, në vargjet e Robert Shkurtit është në harmoni me gjendjet tona shpirtërore, me lumturinë, pikëllimin, humbjen, por, pse jo, edhe me rikthimin. I gjithë libri dëshmon për respektimin e disiplinës së këtij vargu aspak të lehtë, për aftësinë për të pikturuar një kuadër të gjallë natyre me shumë pak fjalë, ku çdo fjalë, çdo rrokje ka rëndësinë e saj dhe ku ritmi është gati i pandieshëm, por i pazëvendësueshëm. Ku nuk ndihet domosdoshmërisht nevoja e rimës, por ku ato tri vargje të kursyera 5-7-5 rrokëshe janë një imazh poetik që shprehin një botë të madhe.

***Diana Çuli***



\*\*\*

Vitet e mia  
peshohen në kalendar.  
Të rënda fletët.

\*\*\*

Gjueti ndjenjash,  
lëshoj ca klithma pushke.  
Rënkim i mbytur.

\*\*\*

Lojë kumari  
puthem me çupën zemër.  
Furtunë lulesh.

\*\*\*

Me litarë shiu,  
retë shkarkojnë dhimbje.  
Oazet bosh.

\*\*\*

Në ecje vitesh,  
ndërrojmë fletët e kohës,  
por jo zemrën.

\*\*\*

I qullur hiri  
kërkoj rininë e humbur.  
Zemër shkrumbuar.

\*\*\*

Lotët stalagmit  
shkrijnë me llavë zemre.  
Sytë ujëvarë.

\*\*\*

Thepisje shpirti,  
mbahem buzëve të tua,  
unaza cirku.

\*\*\*

Vetullat harqe  
sytë e saj shigjetë.  
Zemër e plagosur

\*\*\*

Romanit jetë,  
plot histori misteri.  
Thriller dashurie.

\*\*\*

Me buzët e tua  
era bën serenatë.  
Mbrëmje korçare.

\*\*\*

Duele zemrash,  
nuk mbrohem me hekur.  
Thembra shpëtimtare.

\*\*\*

Yjet e fshehur  
meteorë të dashurisë.  
Pendim i vonë.

\*\*\*

Retë e mpleksura  
ndjellin duele zemrash.  
Rrebeshe lotësh.